



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 696, datë 21.11.2023

PËR

VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT ARDIT MUSTAJ, PËR VITIN 2019

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit Ardit Mustafaj, për vitin 2019”, i hartuar nga relatore znj. Yllka Rupa,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtarit Ardit Mustafaj, për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI.

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsyetimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy treguesve, njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor, të cilët ndahen në disa nëntregues.

1-A Njohuritë ligjore.

1-A-a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit konstatohet se në të gjitha vendimet e dhëna, gjyqtari ka aftësi shumë të mira në përcaktimin e fakteve të çështjes penale objekt shqyrtimi. Në vendimet e saj, fillimisht gjyqtari ndalet dhe përshkruan rrethanat dhe faktet e çështjes, më pas përcakton natyrën e çështjes dhe fazën procedurale në të cilën është çështja objekt gjykimi, citon dispozitat ligjore në lidhje me ekzistencën e faktit penal, duke përfunduar me identifikimin dhe citimin e dispozitave procedurale, në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Paraqitja dhe analiza e rrethanave të faktit në çdo rast është e detajuar, e qartë dhe e plotë duke përshkruar ngjarjen gjatë së cilës ka ndodhur fakti penal/faktet penale, rolin e të pandehurit/ve në realizimin e tij, veprimet që tregojnë bashkëpunimin midis të pandehurve etj. Pas paraqitjes dhe analizës së faktit penal në pjesën e parë apo të dytë të arsyetimit të vendimit, si në çështjet në të cilat është proceduar me gjykim të shkurtuar ashtu edhe në ato në të cilat është proceduar me gjykim të zakonshëm, gjyqtari bën paraqitjen e provave duke evidentuar, në një pjesë të tyre, elementët e faktit që rezultojnë të mbështetur në secilën provë. Paraqitja e rrethanave të faktit dhe paraqitja e provave mbi të cilat mbështetet, në disa raste bëhet duke cituar në mënyrë eksplicite përmbajtjen e provës përkatëse (*në rastin e dëshmive, bisedave telefonike të transkriptuara etj.*) në shërbim të vërtetimit të ekzistencës së faktit penal dhe rolit të të pandehurve, i jep qartësi faktit penal dhe mbështetet provueshmërinë e fakteve objekt gjykimi.

Gjithashtu, paraqitja dhe analiza e rrethanave të faktit, kur është e nevojshme, përqendrohet edhe në evidentimin e elementëve apo veprimeve që provojnë ekzistencën e rrethanave të tilla si, formën e kryerjes së veprës penale, elementët e bashkëpunimit ose mungesën e tyre,

mbetjen e veprave penale në fazën e tentativës, lidhjen shkakësore, autorësinë, analizën e elementëve cilësues të veprave penale për të cilat procedohet, etj. Provat dhe faktet e paraqitura nga mbrojtja e të pandehurit/të paditurit, evidentohen në mënyrë të hollësishme në përmbajtjen e arsytimit të vendimit, si dhe në pjesën që i kushtohet individualizimit të dënimit në rastet kur provat dhe faktet kanë lidhje me këtë aspekt.

Në tërësi, evidentohet se gjyqtari, i jep rendësi përshkrimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, të cilat pavarësisht se nuk rezultojnë si një nën pjesë e titulluar “Rrethanat e faktit”, referuar mënyrës së përshkrimit të rrethanave të çështjes në përputhje dhe i integruar me provat e administruara, faktet evidentohen lehtësisht.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në të gjitha vendimet gjyqësore burim vlerësimi rezultojnë se gjyqtari ka identifikuar dhe përcaktuar qartë ligjin e zbatueshëm, duke cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat e ligjit procedural dhe material, të cilat merren në analizë në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të karakterit procedural, apo zgjidhjen në themel të çështjes.

Sa i përket ligjit procedural:

- Citon nenin 58 të K. Pr. Penale në lidhje me të drejtat e viktimës së veprës penale, nenin 75/a të K. Pr. Penale në lidhje me kompetencën lëndore, nenin 128/a pika 1/b të K. Pr. Penale në lidhje me pavlefshmërinë absolute për shkak të mosrespektimit të dispozitave mbi të drejtën e prokurorit për pjesëmarrje në procedim, nenin 151 të K. Pr. Penale në lidhje me marrjen e provave, nenin 166 të K. Pr. Penale në lidhje me kërkesën për pyetjen e të pandehurit/të paditurit civil, nenin 188 të K. Pr. Penale në lidhje me marrjen e provave materiale, nenin 190/1 të K. Pr. Penal në lidhje me disponimin për provat materiale, nenin 256 të K. Pr. Penale në lidhje me marrjen në pyetje të personit të ndaluar/arrestuar, nenin 259 të K. Pr. Penale në lidhje me seancën e vleftësimit, nenin 296 të K. Pr. Penale në lidhje me marrjen e të dhënave për personin ndaj të cilit zhvillohen hetime, nenin 370/2 të K. Pr. Penale në lidhje me leximin e deklarimeve të bëra nga i pandehuri, nenin 371 të K. Pr. Penale në lidhje me futjen e akteve më fashikullin e gjykatës, nenin 403/2 të K. Pr. Penale në lidhje me gjykimin e shkurtuar, nenin 12 dhe 17 të K. Penal në lidhje me subjektin e veprës penale dhe përgjegjshmërinë e tij, nenin 47 të K. Penal në lidhje me caktimin e dënimit, nenin 48 dhe 49 të K. Penal në lidhje me rrethanat lehtësuese, nenin 50 të K. Penal në lidhje me rrethanat rënduese¹
- Nenet 140-142 të K. Pr. Penale në lidhje me njoftimin për të pandehurin, nenin 147 të K. Pr. Penale në lidhje me rivendosjen në afat, nenin 152 të K. Pr. Penale në lidhje me çmuarjen e provave, nenin 154 të K. Pr. Penale në lidhje me dëshminë indirekte, nenin 188 të K. Pr. Penale në lidhje me marrjen e provave materiale, nenet 328/1/e dhe 387 të K. Pr. Penale në lidhje me pushimin e çështjes, nenin 351 dhe 352 të K. Pr. Penale përkatësisht në lidhje me mosparaqitjen ose largimin e vullnetshëm të të pandehurit dhe gjykimin në mungesë, nenet 372-376 të K. Pr. Penale në lidhje me akuzat e reja, ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale dhe të drejtat e palëve, nenet 332/ë, 403 dhe 405 të K. Pr. Penale në lidhje me kërkesën dhe procedimin me gjykim të shkurtuar, nenin 388 të K. Pr. Penale në lidhje me vendimin e pafajësisë,

¹ Në vendimin nr. 31, datë 23.04.2019, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (me objekt gjykimin për veprën penale të parashikuar nga neni 79/c i K.Penal)

nenin 420 të K. Pr. Penale në lidhje me mospranimin e ankimit, nenin 441 dhe 443 të K. Pr. Penale në lidhje me vendimet e Gjykatës së Lartë dhe vendimin e saj për prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve për rishqyrtim, nenin 450 të K. Pr. Penale në lidhje me rastet e rishikimit,²

- Citon nenet 228 dhe 229 të K. Pr. Penale në lidhje me kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit, nenin 230 të K. Pr. Penale në lidhje me kriteret e veçanta për caktimin e masës së sigurimit “*Arrest në burg*”, nenin 238 të K. Pr. Penale në lidhje me masën e sigurimit “*Arrest në burg*”, nenin 246/6 të K. Pr. Penale në lidhje me detyrimin e prokurorit për të informuar gjykatën me shkrim mbi gjendjen e procedimit, nenin 260/2 të K. Pr. Penale në lidhje me zëvendësimin e masës së sigurimit³,
- Citon nenin 74 të K. Pr. Penale në lidhje me kompetencën lëndore, nenet 83 dhe 85 të K. Pr. Penale në lidhje me disponimin për moskompetencën, nenin 93/2 të K. Pr. Penale në lidhje me ndarjen e çështjes, nenin 128/a pika 1/b të K. Pr. Penale në lidhje me pavlefshmërinë absolute për shkak të mosrespektimit të dispozitave mbi të drejtën e prokurorit për pjesëmarrje në procedim, nenin 152 të K. Pr. Penale në lidhje me çmuarjen e provave, nenin 190/1 të K. Penal në lidhje me disponimin për provat materiale, nenin 256 të K. Pr. Penale në lidhje me marrjen në pyetje të personit të ndaluar/arrestuar, nenin 296 të K. Pr. Penale në lidhje me marrjen e të dhënave për personin ndaj të cilit zhvillohen hetime, nenin 375/1 të K. Pr. Penale në lidhje me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, nenet 403 dhe 405 të K. Pr. Penale në lidhje me gjykimin e shkurtuar, nenin 12 dhe 17 të K. Penal në lidhje me subjektin e veprës penale dhe përgjegjshmërinë e tij⁴
- Citon nenin 7 të K. Pr. Penale në lidhje me ndalimin e gjykimin dy herë për të njëjtin fakt, nenin 152 të K. Pr. Penale në lidhje me çmuarjen e provave, nenin 36 të K. Penal dhe nenin 190/1 të K. Penal në lidhje me disponimin për provat materiale, nenin 375/1 të K. Pr. Penale në lidhje me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, nenin 405 të K. Pr. Penale në lidhje me gjykimin e shkurtuar,⁵
- nenin 75/a të K. Pr. Penale në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatës, nenin 93/1 të K. Pr. Penale në lidhje me ndarjen e çështjeve, nenin 140 e vijues në lidhje me njoftimin e të pandehurit, nenin 152 të K. Pr. Penale në lidhje me çmuarjen e provave, nenin 190/1 të K. Penal në lidhje me disponimin për provat materiale, nenin 352 të K. Pr. Penale në lidhje me gjykimin në mungesë, nenet 403 dhe 405 të K. Pr. Penale në lidhje me gjykimin e shkurtuar,⁶
- Citon nenin 328/1 gërma (dh) dhe (f) të K. Pr. Penale në lidhje me pushimin e çështjes kur del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai, si dhe për rrethana të tjera të parashikuara nga ligji,⁷

2 Në vendimin nr. 60, datë 19.09.2019, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (me objekt gjykimin e të pandehurve për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 i K. Penal)

3 Në vendimin nr. 423, datë 29.10.2019, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (me objekt zëvendësimin e masës së sigurimit),

4 Në vendimin nr. 7, datë 24.01.2019, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (me objekt gjykimin për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a2-22 i K.Penal),

5 Në vendimin nr. 77, datë 22.11.2019, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (me objekt gjykimin për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a2-22 i K.Penal),

6 Në vendimin nr. 40, datë 24.05.2019, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (me objekt gjykimin për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a2 i K.Penal),

7 Në vendimin nr. 128, datë 13.12.2019, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (me objekt revokimin e vendimit të pushimit),

- Citon nenin 328/1/dh të K. Pr. Penale në lidhje me pushimin e çështjes penale kur del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën,⁸

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, rezulton se gjyqtari identifikon dhe/ose citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në shmangien e citimit apo të listimit të dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk referojnë drejtpërdrejt në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, konstatohet se:

- nenin 248 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Shpërdorimi i detyrës”*, nenin 283/a të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Trafikimi i narkotikëve”*, nenin 333/a të K. Penal në lidhje me grupin e strukturuar kriminal, nenin 334 të K. Penal në lidhje me kryerjen e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, nenin 5 të ligjit nr. 9110, datë 24.07.2003 *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”* në lidhje me ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale, nenin 5 të ligjit nr. 90/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”* në lidhje me ministrin përgjegjës, nenin 6 dhe 7 të ligjit nr. 9000/2003 *“Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”* në lidhje me ministrin dhe ministrinë, ligjin nr. 9861, datë 24.01.2008 *“Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror”*, ligjin nr. 9749 datë 04.06.2007 *“Për policinë e shtetit”* dhe ligjin e ri nr. 108/2014 *“Për policinë e shtetit”* dispozitat përkatëse në lidhje me kompetencat e policisë së shtetit, oraginizimin dhe funksionimin e saj, përgjegjësitë e ministrit, drejtorit të policisë së shtetit etj., VKM nr. 750, datë 16.09.2015 *“Për miratimin e rregullores së Policisë së Shtetit”*, si dhe VKM nr. 942, datë 09.10.2013 *“Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Punëve të Brendshme”*.
- nenin 79/c të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”*, si dhe nenin 13 të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”* në lidhje me burgun e sigurisë së lartë.
- nenin 25 të K. Penal në lidhje me bashkëpunimin, si dhe neni 109/b të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”*.
- nenin 283/a të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Trafikimi i narkotikëve”*, si dhe ligjin nr. 7975, datë 26.07.1995 *“Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”*.
- nenin 283/a të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Trafikimi i narkotikëve”*, nenin 334 të K. Penal në lidhje me kryerjen e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, ligjin nr. 7975, datë 26.07.1995 *“Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”*, si dhe ligjin nr. 8328, datë 16.04.1998 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, përkatësisht nenin 13 në lidhje institucionin për ekzekutimin e dënimit për subjekte të krimit të organizuar.
- nenin 300 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Moskallëzimi i krimit”*, nenin 302 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Përkrahja e autorit të veprës penale”*, si dhe ligjin nr. 7975, datë 26.07.1995 *“Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”*.
- nenin 245 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”*, nenin 301 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës”*, nenin 319 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të*

⁸ Në vendimin nr. 41, datë 08.04.2019, të Gjykatës së së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (me objekt pushim çështje)

drejtësisë”, nenin 319/ç të K. Penal në lidhje me veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”.

Krahas dispozitave të Kodit Penal, dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtari ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe dispozitat e Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës si më poshtë:

- Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventën Evropiane për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjykimeve Penale, nenin 14/7 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe nenin 4 të Protokollit 7 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore në lidhje me parimin *ne bis in idem*,
- nenin 34 të Kushtetutës dhe nenin 7 të K. Pr. Penale në lidhje me parimin *ne bis in idem*,
- nenin 42 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën për një proces të rregullt ligjor,
- nenin 102/4 të Kushtetutës në lidhje me funksionin e ministrit,

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtari ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret.

KONKLUZION

Në tërësi, gjyqtari shfaq aftësi shumë të mira në drejtim të paraqitjes dhe analizës të qartë dhe të plotë të fakteve të çështjes, duke i integruar dhe me një analizë të detajuar të provave. Evidentohen aftësitë e gjyqtarit në lidhje me identifikimin dhe përcaktimin e ligjit të zbatueshëm, duke referuar ose cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat e ligjit procedural dhe material, të cilat merren në analizë në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të karakterit procedural, apo zgjidhjen në themel të çështjes. Pra rezulton se gjyqtari shfaq aftësi shumë të mira në lidhje me përcaktimin e natyrës juridike të marrëdhënies objekt shqyrtimi, si dhe identifikimi i normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale të akteve ligjore dhe nënligjore që gjejnë zbatim mbi faktet objekt shqyrtimi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” është “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se në vendimet objekt vlerësimi, identifikimi i normës juridike si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore me natyrë procedurale apo materiale, citohen ose referohen, duke u shoqëruar në çdo rast me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes.

Në çdo rast, citimi i dispozitave integrohet me një fakt të caktuar apo me konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen. Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e

gjyqtarit sipas mënyrës së interpretimit të tyre në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Në lidhje me dispozitat e ligjit penal material, evidentohet interpretimi i dispozitave materiale, në funksion të kualifikimit juridik të faktit penal, interpretim ky i bërë në përputhje me rrethanat e faktit dhe provat e shqyrtuara. Interpretimi i dispozitës materiale bëhet jo vetëm në këndvështrim teorik, por duke u ndalur në çdo rrethanë fakti të dalë nga shqyrtimi gjyqësor dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, me qëllim arrijten e konkluzioneve të qarta dhe logjike për ekzistencën e fakteve, autorësinë e veprave penale dhe provueshmërinë tyre, në mënyrë të plotë, duke trajtuar në këtë aspekt, edhe çdo pretendim apo kërkesë të palëve në proces.

- ***Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:***

Gjyqtari interpreton dispozitat materiale dhe dispozitat e pjesës së përgjithshme të K.Penal, në drejtim të elementëve dhe instituteve, si më poshtë:

- Merr në analizë veprën penale “*Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare*” parashikuar nga neni 79/c i K. Penal. Në këtë kuadër, evidenton se për cilësimin e saj merret për bazë kriteri objekti, pra fakti se ndaj kujt drejtohet vepra penale, cili është objekti i figurës së krimit dhe jo kriteri subjektiv, ku përfshihen edhe motivet që mund të kenë shtyrë autorin në kryerjen e veprës penale apo qëllimi që ka synuar të arrijë.
- Referon jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, përkatësisht vendimin penal njësuës nr. 00-2018-148 (13), datë 04.04.2018 në lidhje me kompetencën për gjykimin e veprave penale të parashikuar nga neni 75/a i K. Pr. Penale para ndryshimit me ligjin nr. 35/2017.
- Analizon elementët e nevojshëm në kuadër të caktimit të dënimit, referuar nenit 47 të K. Penal, duke aplikuar parimin e individualizimit të dënimit. (*vendimin nr. 31, datë 23.04.2019, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (me objekt gjykimin për veprën penale të parashikuar nga neni 79/c i K.Penal)*).
- Trajton parimin e ndalimit të gjykimit dy herë për të njëjtin fakt (*ne bis in idem*), duke evidentuar kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar të zbatueshëm, jurisprudencën e GJEDNJ, përkatësisht vendimin Xheraj kundër Shqipërisë, si dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht vendimin nr. 2, datë 16.01.2013. Në këtë kuadër, evidenton edhe konceptin e “*gjësë së gjykuar*” referuar vendimit Unifikues nr. 2/2014 të Kolegjeve të bashkuara të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, citon dhe aplikon edhe parime të tjera të së drejtës, përkatësisht parimin e procesit të rregullt ligjor, parimin se çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit, parimin e provueshmërisë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, parimin e individualizimit të dënimit etj. Analizon tërësinë e provave të paraqitura, në kuadër të vërtetimit të veprimeve të kryera prej të pandehurve për efekt të akuzës së paraqitur nga prokuroria, përkatësisht për veprat penale të “*Trafikimit të narkotikëve*” në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, “*Grupit të strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të K. Penal. Në këtë kuadër, citohen dhe mbahen në konsideratë edhe qëndrimet Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, përkatësisht vendimi Unifikues nr. 3/2011 në lidhje me trafikimin e narkotikëve, si dhe vendimi Unifikues nr. 4/2011 në lidhje me bashkëpunimin. Trajton veprën penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, parashikuar nga neni 248 i K. Penal,

duke zhvilluar analizën e elementeve të saj, për të konkluduar mbi vërtetimin e tyre në rrethanat e çështjes objekt gjykimi. Analizon përgjimet dhe vlerën e tyre në rastin kur bashkëbiseduesit i referohen personave të tretë, duke mbajtur në konsideratë edhe praktikën e Gjykatës së Lartë, përkatësisht vendimin nr. 97, datë 20.03.2013 të Kolegjit Penal. Trajton të drejtën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda për të ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale, edhe kur nuk është kompetente për gjykimin e kësaj të fundit, duke evidentuar kuadrin ligjor përkatës, si dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht vendimin nr. 4/2012. Merr në analizë individualizimin e dënimit referuar rrethanave konkrete të çështjes. Gjithashtu, analizon alternativën e pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë referuar nenit 59 të K. Penal, duke evidentuar kushtet që duhet të plotësohen për aplikimin e saj referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë, përkatësisht vendimeve nr. 14 datë 08.02.2017 dhe nr. 21, datë 09.02.2017 të Kolegjit Penal. (Në vendimin nr. 60, datë 19.09.2019, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (me objekt gjykimin e të pandehurve për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 i K. Penal)

- Citon vendimin Unifikues nr. 1, datë 08.01.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në lidhje me dilijencën që duhet të tregojë prokurori gjatë hetimeve paraprake.
- Analizon kushtet dhe kriteret e parashikuara nga neni 228, 229 dhe 230 të K. Pr. Penale për të konkluduar mbi vijimësinë e zbatimit të masë së sigurimit “*Arrest në burg*”, parashikuar nga neni 238 i K. Pr. Penale (Në vendimin nr. 423, datë 29.10.2019, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (me objekt zëvendësimin e masës së sigurimit),
- Merr në analizë zbatueshmërinë e nenit 296/1 të K. Pr. Penale në lidhje me nenin 256/1 të K. Pr. Penale të ndryshuar, mbi parashikimin për pyetjen e personit të arrestuar në flagrancë/të ndaluar prej prokurorit, duke evidentuar pasojën e moszbatimit të tyre, përkatësisht pavlefshmërinë absolute të aktit procedural referuar nenit 128/a pika 1/b të K. Pr. Penale. Gjithashtu, merr në analizë elementet e veprës penale “*Trafikimi i narkotikëve*” në bashkëpunim mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a/2-22 të K. Penal, prej nga konkludon se nuk provohet elementi i bashkëpunimit, e për pasojë me ndryshimin e cilësimit juridik në “*Trafikimi i narkotikëve*” mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a/1-22 të K. Penal. Analizon elementët e nevojshëm në kuadër të caktimit të dënimit, referuar nenit 47 të K. Penal. (Në vendimin nr. 7, datë 24.01.2019, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (me objekt gjykimin për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a2-22 i K. Penal),
- Merr në analizë faktin penal referuar kërkesës së prokurorisë për gjykimin e të pandehurit për veprën penale “*Trafikimi i narkotikëve*” në bashkëpunim mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a/2-22 të K. Penal, prej nga konkludon se bashkëpunimi i të pandehurit me pjesëmarrësit e tjerë plotëson kushtet e grupit të strukturuar kriminal si formë e posaçme e bashkëpunimit, e për pasojë referuar nenit 375/2 të K. Pr. Penale ndryshon cilësimin juridik në “*Trafikimi i narkotikëve*” mbetur në tentativë kryer në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 283/a/1 në lidhje me nenet 22, 28/4 të K. Penal. Citon dhe aplikon parimin e ndalimit të gjykimit dy herë për të njëjtin fakt, referuar nenit 7 të K. Pr. Penale. Referon jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, përkatësisht vendimin penal njësues nr. 00-2018-148 (13), datë 04.04.2018 në lidhje me kompetencën për gjykimin e veprave penale të parashikuar nga neni 75/a i K. Pr. Penale para ndryshimit me ligjin

nr. 35/2017. Gjithashtu, referon jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë, përkatësisht vendimin nr. 4, datë 15.04.2011 në lidhje me bashkëpunimin. Analizon elementët e nevojshëm në kuadër të caktimit të dënimit, referuar nenit 47 të K. Penal. (Në vendimin nr. 77, datë 22.11.2019, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (me objekt gjykimin për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a2-22 i K.Penal),

- Merr në analizë elementet e veprës penale “*Trafikimi i narkotikëve*” në bashkëpunim parashikuar nga neni 283/a/2 i K. Penal, prej nga konkludon për verifikimin e secilit prej tyre. Referon jurisprudencën Unifikues të Gjykatës së Lartë, përkatësisht vendimin nr. 4, datë 15.04.2011 në lidhje me bashkëpunimin dhe vendimin nr. 3, datë 24.01.2011 në lidhje me veprën penale “*Trafikimi i narkotikëve*”. Analizon elementët e nevojshëm në kuadër të caktimit të dënimit, referuar nenit 47 të K. Penal. (Në vendimin nr. 40, datë 24.05.2019, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (me objekt gjykimin për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/2 i K.Penal),
- Merr në analizë nenin 329/c të K. Pr. Penale të ndryshuar. Në këtë kuadër, fillimisht sqaron se pavarësisht se vendimi i pushimit është marrë nga prokurori pasi kështu kërkohej nga ligji procedural i kohës, për revokimin e tij do të zbatohen dispozitat procedurale penale aktuale, sipas të cilave revokimi vendoset në dhomë këshillimi nga gjyqtari i seancës paraprake. Në vijim, merr në analizë verifikimin e nenin 329/c të K. Pr. Penale në lidhje me revokimin e vendimit të pushimit në rrethanat e çështjes konkrete. (Në vendimin nr. 128, datë 13.12.2019, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (me objekt revokimin e vendimit të pushimit),
- Analizon anën objektive të veprës penale “*Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë*” parashikuar nga neni 319/ç i K. Penal në rrethanat e çështjes objekt gjykimi, për të konkluduar mbi mosverifikimin e saj, e rrjedhimisht për pushimin e çështjes penale për shkak se del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën, referuar nenit 328/1/dh të K. Pr. Penale. (Në vendimin nr. 41, datë 08.04.2019, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (me objekt pushim çështje)

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural apo kur ato shërbejnë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Gjyqtari referon dhe interpreton dispozitat e ligjit material, duke i zbërthyer ato në funksion të dispozitës para aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete. Evidentohet kujdesi i gjyqtarit për identifikimin dhe zbatimin e praktikës relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë dhe të GJEDNJ. Gjithashtu, evidentohet kujdesi i gjyqtarit në referimin dhe zbatimin e parimeve të së drejtës si në aspektin procedural ashtu edhe në atë material apo thelbësor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në lidhje me treguesin “*Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes*”, vlerësohet “*Shumë e lartë*”, dhe duhet pikezuar me 25 pikë.

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtari gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Në përdorimin e instituteve, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në një procedim penal, gjyqtari përdor shpesh termat latinë, por duke sqaruar kuptimin e tyre paraprakisht, si përtej çdo dyshimi të arsyeshëm – *in dublo pro reo*; parimi i gjësë së gjykuar – *ne bis in idem*; mosrëndimi i pozitës së të pandehurit etj.

Gjithashtu, citon dhe aplikon edhe parime të tjera të së drejtës, përkatësisht parimin e procesit të rregullt ligjor, parimin se çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit, parimin e provueshmërisë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, parimin e individualizimit të dënimit etj. Nuk evidentohet përdorim i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe shmang përdorimin e fjalëve fyese apo denigruese.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës. Evidentohet në mënyrë të veçantë në të gjitha vendimet gjyqësore përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç). Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra-tjetrës dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren. Vendimi është i organizuar me paragrafë, të cilët lidhen me njëri-tjetrin përmes kronologjisë së mendimit

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve apo shprehjeve që mund cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyese apo denigrues.

Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, paragrafët apo nënndarjet e arsyetimit të vendimit gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Gjyqtari ndërton përgjithësisht fjali me gjatësi normale, megjithatë, konstatohet edhe përdorimi i fjalive të gjata, me qëllim mosndërprerjen e vijimësisë së mendimit. Fjalitë janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që të transmetojnë mendimin dhe të lidhen me njëra-tjetrën për nga vijimësia e kuptimit. Në çdo rast mendimi është shprehur në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë, paragrafët dhe nënndarjet e arsyetimit të vendimit, në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës. Vendimet në përgjithësi janë të organizuar në nënndarje, të identifikuar në shumicën e vendimeve me tituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e tyre, dhe brenda nënndarjeve, në paragrafë, të cilët lidhen me njëri-tjetrin përmes kronologjisë dhe vazhdimësisë së mendimit.

Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente, vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i tyre, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh në ligjin e posaçëm (ligji nr. 7975 datë 26.07.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”) apo në aktet e

ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme dhe të ndryshme nga ato juridike.

KONKLUZIONI

Referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë, të arsyetimit ligjor në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.*

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjyqtari ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar në hartimin e vendimit, duke evidentuar ndarjet dhe nëndarjet e pjesës së vendimit, me qëllim pasqyrimin e strukturuar të pjesëve të domosdoshme të vendimit gjyqësor, pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin. Gjithashtu konstatohet se gjyqtari në rastin konkret ka një metodologji të qartë, duke iu referuar pjesëve përbërëse të vendimit, të cilat edhe pse nuk ndahen në mënyrë të qartë me nëndarje të përcaktuara me tituj, në çdo vendim, del qartë pjesa hyrëse, pjesa përshkruese-arsyetuese si dhe dispozitivi i tij.

Pjesa hyrëse e të gjitha vendimeve përmban të gjithë elementët e nevojshëm në lidhje me përcaktimin e gjykatës, përbërjen e trupit gjykues, kohës së zhvillimit të gjykimit, të dhënat e plota të palëve dhe përfaqësuesve të tyre, akuzën e plotë ose objektin e kërkesës dhe nenet përkatëse të Kodit Penal, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve në mënyrë të përmbledhur.

Pjesa përshkruese- arsyetuese e vendimeve gjithashtu ndjek një strukturë të mirë përcaktuar, e cila ndiqet në çdo rast, të organizuar me paragrafë me qëllim orientimin e lexuesit. Organizimi i arsyetimit të vendimeve gjyqësore burim vlerësimi, referuar natyrës së gjykimit (*gjykim penal themeli apo kërkesë penale*) apo llojit të gjykimit të zhvilluar (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*), rrethanat e faktit parashtrohen në pjesën e parë apo të dytë të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit, duke u përshkruar fakti penal sikurse ai ka rezultuar i provuar në gjykim, nga tërësia e provave të administruara. E gjithë përmbajtja e vendimit është e ndarë në paragrafë të cilat edhe pse nuk përmbajten numërtim ose gërmëzim, lidhen me njëri tjetrin duke krijuar vijueshmëri të arsyetimit.

Dispozitivi i vendimeve është i plotë, i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, duke përmbajtur në mënyrë të qartë të gjitha disponimet e gjykatës lidhur me fajësinë ose pafajësinë e të pandehurve, akuzën përkatëse, nenet respektive të Kodit Penal, llojin dhe masën e dënimit, uljen e dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar kur është aplikuar, kohën e fillimit të llogaritjes së tij, disponimin e plotë për provat materiale, shpenzimet procedurale si dhe të drejtën e ankimit.

Gjyqtari ndjek rregulla të qarta në strukturimin e vendimit gjyqësor sipas pjesëve të vendimit, zbaton rregullat e shkrimit ligjor duke identifikuar faktet, provat, argumentimin ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm, dhe konkluzionin e arritur.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, e cila është e dukshme në aspektin vizual dhe të përmbajtjes, duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit. Ndjekja e një strukture të njëjtë, të mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecures logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se arsyetimi i vendimeve përfundimtare të vëzhguara, përgjithësisht ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material penal. Në secilin vendim, shtjellohen argumentet e gjykatës në mënyrë logjike, duke u integruar me faktet e provuara në gjykim dhe duke u ndalur në analizën në format e veçanta të bashkëpunimit, etj.

Në çdo vendim burim vlerësimi, gjyqtari merr në analizë ligjin e zbatueshëm. Arsyetimi i vendimeve burim vlerësimi ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material penal, duke bërë një analizë tërësore të provave të administruara, në funksion të përcaktimit të qartë të fakteve të vlerësuara si të provuara në gjykim. Dispozitat ligjore interpretohen si dhe aplikohen mbi faktet e çështjes konkrete, në shërbim të zgjidhjes së saj. Gjyqtari, analizon institutet dhe konceptet ligjore, në dobi të konkluzioneve të arritura në lidhje me natyrën e mosmarrëveshjes si dhe të zgjidhjes së saj në themel.

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi gjyqtari kujdeset për të evidentuar në mënyrë të qartë thelbin e konfliktit/çështjes, duke orientuar analizën juridike dhe duke zhvilluar argumentimin logjik të saj, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtari analizon dhe vlerëson tërësinë e provave të paraqitura për të konkluduar mbi elementët e veprës penale. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe gjithëpërfshirës, duke i dhënë përgjigje të argumentuar të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse si dhe çështjeve të ngritura kryesisht për diskutim.

Konstatohet një analizë e detajuar e fakteve të cilat kanë rezultuar të provuara në gjykim dhe marrja në analizë e tyre në drejtim të ekzistencës së elementëve të figurës së veprës penale për të cilën procedohet dhe autorësinë e saj. Në çdo rast interpretimi dhe analiza e integruar e normave ligjore procedurale dhe materiale, në raport me faktet e provuara në gjykim, i shërben arsyetimit ligjor dhe zhvillimit të argumentimin logjik, në drejtim të figurës konkrete të veprës penale për të cilën procedohet dhe elementët e saj si dhe në lidhje me autorësinë e të pandehurit.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor. Pretendimet e palëve merren gjithmonë në shqyrtim dhe analizohen në pjesën përkatëse të arsytimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret, duke u dhënë një përgjigje të argumentuar dhe duke u analizuar në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Në vendimet e analizuara, evidentohet kujdesi i gjyqtarit për të nxjerrë në mënyrë të qartë thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar analizën juridike në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Arsyetimi i vendimeve është i qartë dhe i plotë duke marrë në analizë dhe dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve, në funksion të zgjidhjes së çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Gjyqtari subjekt vlerësimi ka gjykuar në total 57 çështje për të cilat ligji ka parashikuar afate gjykimi, nga të cilat 17 jashtë këtij afati.⁹ Konkretisht, rezulton të jenë gjykuar jashtë afatit ligjor çështjet si më poshtë vijon:

- Në tabelën nr. 2, çështjet me nr. rendor 1, 5, 6, 7, 9, 10, 11, 12, 13 dhe 15 me objekt “Revokim mase sigurimi”, të cilat janë gjykuar në afatin 7 ditë, 6 ditë, 29 ditë, 11 ditë, 7 ditë, 21 ditë, 20 ditë, 22 ditë, 20 ditë dhe 16, ndërkohë që neni 260 i K. Pr. Penale ka parashikuar afatin ligjor të gjykimit 5 ditë.
- Në tabelën nr. 2, çështja me nr. rendor 8, me objekt “Kundërshtimin e vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimit”, e cila është gjykuar në afatin 1 muaj e 3 ditë, ndërkohë që neni 325 i K. Pr. Penale ka parashikuar afatin ligjor të gjykimit 10 ditë.
- Në tabelën nr. 2, çështjet me nr. rendor 19, 20, 24 dhe 25, me objekt “Caktim mase sigurimi”, të cilat janë gjykuar në afatin 9 ditë, 7 ditë, 9 ditë dhe 8 ditë, ndërkohë që referuar neneve 244 e vijues të K. Pr. Penale, derivon afatin ligjor i gjykimit 48 orë.
- Në tabelën nr. 3, çështjet me nr. rendor 1 dhe 8, me objekt “Dërgim çështje në gjyq”, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatet 3 muaj dhe 2 muaj e 15 ditë ndërkohë që neni 332 i K. Pr. Penale ka parashikuar afatin ligjor të gjykimit 30 ditë.

Sa më sipër, referuar të dhënave statistikore, rezulton se gjyqtari Ardit Mustafaj ka gjykuar 29% të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Referuar vetëvlerësimit të gjyqtarit sipas formularit të integruar të vlerësimit, rezulton se: Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “*Respektimi i afateve ligjore*” në shkallë shumë të lartë (nga pesë nivelet: e dobët; nën mesatare; mesatare; mbi mesataren; shumë e lartë). Ky vetëvlerësim është argumentuar si vijon: “Çështjet në tërësi janë gjykuar brenda afateve ligjore. Në ato raste kur ka pasur tejkalim të afateve, ato gjithmonë kanë qenë të shkurtra dhe

⁹ Në përlogaritjen e numrit total të çështjeve për të cilat parashikohet afat ligjor gjykimi, si dhe të atyre të gjykuara jashtë këtij afati është mbajtur parasysh se:

- Së pari, në tabelën nr. 2, çështjet me objekt “Revokim i masës së sigurimit”, kategorizohen në çështje me afat ligjor referuar nenit 260/4 të K. Pr. Penale, i cili ka parashikuar afatin 5 ditor.
- Së dyti, në tabelën nr. 2, çështjet me objekt “Kundërshtimin e vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimit”, kategorizohen në çështje me afat ligjor referuar nenit 325/2 të K. Pr. Penale, i cili parashikon afatin 10 ditor.
- Së treti, në tabelën nr. 2, çështjet me objekt “Caktimin e masës së sigurimit”, kategorizohen në çështje me afat ligjor, referuar neneve 244 e vijues të K. Pr. Penale, prej të cilëve derivon afati i gjykimit 48 orë.
- Së katërti, në tabelën nr. 2, çështjet me objekt “Verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit” kategorizohen në çështje me afat ligjor, referuar nenit 248 të K. Pr. Penale, i cili ka parashikuar se: “1. Jo më vonë se tri ditë nga zbatimi i masës, gjykata e merr në pyetje personin për të cilin ka vendosur arrestin në burg ose në shtëpi. Për masat e tjera të sigurimit, shtrënguese ose ndaluese, gjykata procedon me marrjen në pyetje brenda pesë ditëve nga zbatimi i masës. Mbrojtja ka të drejtë të njihet me aktet dhe të marrë kopje të tyre.”
- Së pesti, në tabelën nr. 2, çështjet me objekt “Lejim përgjimi/zgjatje e afatit të përgjimit” kategorizohen në çështje me afat ligjor, referuar nenit 222 të K. Pr. Penale, i cili ka parashikuar afatin 24 orë.
- Së gjashti, në tabelën nr. 2, çështjet me objekt “Ekzekutim i letërporosisë” (të cilat efektivisht nuk i përkasin kësaj tablele, por tabelës nr. 4) kategorizohen në çështje me afat ligjor referuar nenit 506/3 të K. Pr. Penale, i cili ka parashikuar se: “3. Gjykata disponon ekzekutimin e letërporosisë me vendim brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës.”
- Së shtati, në tabelën nr. 3, çështjet me objekt “Dërgim në gjyq”, kategorizohen në çështje me afat ligjor referuar nenit 332/3 të K. Pr. Penale i cili ka parashikuar se: “3. Gjykata vendos mbi kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të saj.”

tërësisht për shkaqe objektive e të justifikuara (dhe gjykata nga ana e saj ka bërë të gjitha përpjekjet për t'i përfunduar brenda afateve), siç shpjegohet më poshtë:

-Vendimi nr.36, datë 22.01.2019 (Revokim mase sigurimi)

Seanca e parë është zhvilluar brenda 5 ditëve, më datë 18.01.2019. Është përfunduar për 7 ditë për shkak se, me kërkesë të prokurorit, seanca është shtyrë për t'i dhënë kohë prokurorit për të paraqitur informacion me shkrim në lidhje me gjendjen e procedimit dhe provat e marra deri në ato momente në procedimin penal, sipas nenit 246, pika 6, të K.Pr.Penale.

-Vendimi nr.246, datë 22.05.2019 (Zëvendësim mase sigurimi)

Seanca e parë është zhvilluar brenda 5 ditëve, më datë 21.05.2019. Është përfunduar për 6 ditë për shkak se mbrojtësit kërkuan kohë që të saktësojnë një nga provat që kishin paraqitur dhe që ndikonte në zgjidhjen e kërkesës (vertetimin datë 06.02.2019, të lëshuar në emër të fëmijës A.Duro, pasi ishte shënuar ditëlindja e tij gabim dhe nuk përputhej me atë që figuronte në çertifikatën familjare).

-Vendimi nr.293, datë 12.07.2019 (Zëvendësim mase sigurimi)

Unë si gjyqtar e kam marrë për gjykim këtë kërkesë më datë 08.07.2019 (si gjyqtar i gatshëm), pasi më parë e kishte për gjykim gjyqtari L.Hasneziri, i cili më datë 26.06.2019 është pezulluar nga detyra me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Nga momenti i marrjes së kërkesës, unë e kam përfunduar gjykimin brenda 5 ditëve, pra brenda afatit ligjor.

-Vendimi nr.321, datë 10.07.2019 (Zëvendësim mase sigurimi)

Seanca e parë është zhvilluar brenda 5 ditëve, më datë 03.07.2019. Është përfunduar për 11 ditë pasi seanca e parë datë 03.07.2019 është shtyrë për mungesë të prokurorit, seanca e dytë datë 08.07.2019 është shtyrë me kërkesë të mbrojtësit i cili kërkoi që t'i jepej kohë për të përshtatur qëndrimin dhe pretendimet e tij pas ardhjes në dijeni në seancë për kërkesën e prokurorit për pushimin e çështjes penale për njërin nga kërkuesit (Algert Koleci). Gjykimi u përfundua seancën e ardhshme datë 10.07.2019.

-Vendimi nr.404, datë 02.10.2019 (Zëvendësim mase sigurimi)

Seanca e parë është zhvilluar brenda 5 ditëve, më datë 27.9.2019. Është përfunduar për 7 ditë pasi seanca e parë datë 27.9.2019 është shtyrë për mosparaqitje të mbrojtësit të zgjedhur, ku u caktua një mbrojtës kryesisht dhe seanca u shty për të njoftuar mbrojtësin kryesisht.

-Vendimi 412, datë 22.10.2019 (Zëvendësim mase sigurimi)

Seanca e parë është zhvilluar brenda 5 ditëve, më datë 04.10.2019. Është përfunduar për 21 ditë pasi seanca e parë datë 04.10.2019 është shtyrë për mungesë të prokurorit (prokurorët ishin në një mbledhje për të votuar një anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë), ndërsa seanca e dytë datë 08.10.2019 është shtyrë me kërkesë të mbrojtësve që kërkuan t'u jepej kohë për t'u njohur me informacionin me shkrim dhe aktet që paraqiti prokurori në atë seancë gjyqësore. Seancën e ardhshme datë 22.10.2019 çështja u përfundua.

-Vendimi nr.415, datë 22.10.2019 (Marrje informacioni për hetimet dhe për nevojat e sigurimit për personin nën hetim me masë sigurimi "arrest në burg")

Seanca e parë është zhvilluar brenda 5 ditëve, më datë 04.10.2019. Kjo seancë është shtyrë për mungesë të prokurorit (prokurorët ishin në një mbledhje për të votuar një anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë). Seanca e ardhshme është caktuar për datë 08.10.2019 dhe në këtë datë kjo çështje është bashkuar me kërkesën nr.412 akti, datë 30.06.2019 regj. (që është përfunduar me vendimin nr.412, datë 22.10.2019, të cituar më lart nga ana ime).

-Vendimi nr.423, datë 29.10.2019 (Marrje informacioni për hetimet dhe për nevojat e sigurimit për personin nën hetim me masë sigurimi "arrest në burg")

Seanca e parë është zhvilluar brenda 5 ditëve, më datë 11.10.2019.

Është përfunduar për 22 ditë pasi seanca e parë datë 11.10.2019 është shtyrë për mungesë të prokurorit (të gjithë prokurorët ndodheshin në një trajnim tre ditor). Edhe seanca e dytë datë 22.10.2019 është shtyrë për mosparaqitje të prokurorit (ndodhej në gjykime të tjera në zhvillim e sipër në gjykatë, duke pyetur dëshmitarë, të cilat zgjatën dhe për këtë arsye nuk mund të paraqitej në seancë gjyqësore). Në seancën e ardhshme datë 29.10.2019 gjykimi u përfundua.

-Vendimi nr.438, datë 01.11.2019 (Revokim mase sigurimi)

Seanca e parë është zhvilluar brenda 5 ditëve, më datë 15.10.2019.

Është përfunduar për 20 ditë pasi seanca e parë datë 15.10.2019 është shtyrë për t'i dhënë mundësi personit nën hetim që të përfaqësohet nga mbrojtësi i tij i zgjedhur, pasi ai nuk ishte paraqitur. Në seancën e dytë datë 22.10.2019 përsëri nuk u paraqit mbrojtësi i zgjedhur dhe gjykata caktoi një mbrojtës kryesisht dhe shtyu seancën për të thirrur mbrojtësin e caktuar. Në seancën e tretë datë 30.10.2019 nuk u paraqit prokurori. U njoftua drejtuesi i prokurorisë për mungesën e prokurorit. Në seancën e ardhshme datë 01.11.2019 gjykimi u përfundua.

-Vendimi nr.9, datë 21.01.2019 (Shqyrtim mase sigurimi nga gjykata kompetente)

Çështja është me objekt shqyrtim mase sigurimi nga gjykata kompetente sipas nenit 88 të K.Pr.Penale, ku afati i gjykimit sipas kësaj dispozite është 10 ditë. Është përfunduar për 7 ditë, pra brenda afatit.

-Vendimi nr.62, datë 23.04.2019 (Shqyrtim mase sigurimi nga gjykata kompetente)

Çështja është me objekt shqyrtim mase sigurimi nga gjykata kompetente sipas nenit 88 të K.Pr.Penale, ku afati i gjykimit sipas kësaj dispozite është 10 ditë. Është përfunduar për 7 ditë, pra brenda afatit.

-Vendimi nr.145, datë 10.10.2019 (Shqyrtim mase sigurimi nga gjykata kompetente)

Çështja është me objekt shqyrtim mase sigurimi nga gjykata kompetente sipas nenit 88 të K.Pr.Penale, ku afati i gjykimit sipas kësaj dispozite është 10 ditë. Është përfunduar për 9 ditë, pra brenda afatit.

-Vendimi nr.156, datë 01.11.2019 (Shqyrtim mase sigurimi nga gjykata kompetente)

Çështja është me objekt shqyrtim mase sigurimi nga gjykata kompetente sipas nenit 88 të K.Pr.Penale, ku afati i gjykimit sipas kësaj dispozite është 10 ditë. Është përfunduar për 8 ditë, pra brenda afatit.

-Vendimi nr.12, datë 07.03.2019 (Dërgim i çështjes në gjyq)

Është përfunduar për 3 muaj sepse me vendimin e datës 19.12.2018 është urdhëruar prokurori të plotësojë hetimet, bazuar në nenin 332/ç të K.Pr.Penale. Seanca e ardhshme paraprake u caktua për datë 19.02.2019. Kjo seancë u shty sepse mbrojtësi i zgjedhur kishte hequr dorë nga mbrojtja dhe u caktua një mbrojtës kryesisht, i cili u njoftua për seancën e ardhshme datë 25.02.2019. Seanca datë 25.02.2019 u shty në mënyrë që prokurori të paraqiste në gjykatë kopje të vërtetuara të akteve të marra nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë, të cilat në atë seancë i kishte sjellë thjesht fotokopje. Në seancën e ardhshme datë 07.03.2019 gjykimi u përfundua.

-Vendimi nr.107, datë 13.12.2019 (Dërgim i çështjes në gjyq)

Është përfunduar për 2 muaj e 15 ditë sepse me vendimin e datës 14.11.2019 është urdhëruar prokurori të plotësojë hetimet, bazuar në nenin 332/ç të K.Pr.Penale. Seanca e ardhshme paraprake është caktuar për datë 12.12.2019. Në vijim, më datë 13.12.2029 gjykimi u përfundua.".

Kryetari e ka vlerësuar treguesin "Respektimi i afateve ligjore" në shkallë shumë të lartë (nga pesë nivelet: e dobët; nën mesatare; mesatare; mbi mesataren; shumë e lartë).

Në total, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (17 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji parashikon afat ligjor (57 çështje), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar 29 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Sa më lart nga shpjegimet e gjyqtarit në formularin e vetëvlerësimit konstatohet se gjykimi i çështjeve jashtë afati ka ardhur për shkaqe të pavarura nga gjyqtari, si rezultat i ecurisë procedurale, siç janë kërkesa për shtyrje të prokurorit te seancës *që të paraqesë në gjykatë kopje të vërtetuara të akteve, për shkak të heqjes dore nga mbrojtja e avokatit të zgjedhur nga pala, apo kërkesa për shtyrje e mbrojtësve për tu lenë kohe që të njihen me aktet e sjella në seancë nga prokurori.*

Vërehet se nga vendimet burim vlerësimi, çështjet janë vënë në lëvizje gjithmonë brenda 1-3 ditëve pra për një kohe shumë të shkurtër dhe gjate gjithë kohës janë respektuar afatet për shtyrjet e seancave gjyqësorë duke u caktuar shume afër. Nga një përlllogaritje matematikore për disa nga çështjet afati ligjore është tejkualuar nga 1-3 dite çka nënkupton një tejkalim të papërfillshëm duke zbritur përqindjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë afati nga 29% në 22 % e cila përkon sipas metodologjisë me 9 pikë.

Analiza e mësipërme e orienton vlerësuesin në rastin konkret, në përcaktimin e një niveli më të lartë vlerësimi se ai që përkon vetëm nga analiza matematikore e të dhënave statistikore.

Referuar metodologjisë në të cilën përcaktohet se: *Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje, që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, si dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, e cila mund të çojë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme deri në pikëzimin maksimal”,* si dhe shpjegimeve të gjyqtarit në formularin e vetëvlerësimit kuptohet që afatet e gjykimit nuk ka qene e mundur të respektohen kjo për shkak të kompleksitetit të çështjeve, njoftimi të pandehurve me letërporosi, pra shtyrja e seancave gjyqësorë që ka zgjatur në kohë gjykimit, ka qenë tërësisht për shkaqe objektive e të justifikuara në funksion të respektimit hapave procedurale për një proces të rregullt gjyqësorë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, sa më sipër dhe referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësoj se gjyqtari duhet të pikëzohet maksimalisht për këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i afateve ligjore” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se çështjet në përgjithësi kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor.

Referuar të dhënave statistikore rezulton se: Gjyqtari subjekt vlerësimi ka gjykuar në total 15 çështje për të cilat janë parashikuar afate orientuese për standardin minimal kohor,

nga të cilat 1 çështje jashtë këtij afati.¹⁰ Konkretisht, rezulton të jenë gjykuar jashtë afatit standard minimal kohor çështjet si më poshtë vijon:

- Në tabelën nr. 3, çështja me nr. rendor 5, me objekt “*Pushimin e çështjes penale*”, e cila është gjykuar në afatin 3 muaj e 27 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj.

Sa më sipër, referuar të dhënave statistikore, rezulton se Gjyqtari Ardit Mustafaj ka gjykuar 7 % të çështjeve jashtë afatit standard minimal kohor.

Referuar vetëvlerësimit të gjyqtarit sipas formularit të integruar të vlerësimit, rezulton se:

Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “*Plotësimi i standardeve minimale kohore*” në shkallë shumë të lartë (nga pesë nivelet: e dobët; nën mesatare; mesatare; mbi mesataren; shumë e lartë). Konkretisht, subjekti i vlerësimit është shprehur si vijon: “*Çështjet në tërësi janë gjykuar brenda afateve standart. Më poshtë evidentoj dy çështje objekti i të cilave është përshkruar gabimisht në të dhënat statistikore vënë në dispozicion KLGJ-së nga Gjykata, gjë që ndikon te llogaritja e afateve të gjykimit. Nga ana tjetër, në ato raste kur ka pasur tejkalim të afateve, ato gjithmonë kanë qenë të shkurtra dhe tërësisht për shkaqe objektive e të justifikuara (dhe gjykata nga ana e saj ka bërë të gjitha përpjekjet për t’i përfunduar brenda afateve). Konkretisht:*

-Vendimi nr.497, datë 05.12.2019 (Kthim sendi i sekuestruar)

Kërkesa është me objekt kthim sendi i sekuestruar, jo revokim mase sigurimi sikurse është shënuar gabimisht në të dhënat statistikore vënë në dispozicion KLGJ-së nga Gjykata.

Në K.Pr.Penale nuk është parashikuar afat për gjykimin e kërkesave për kthim sendi. Është gjykuar për 16 ditë, pra brenda afatit standart dy muajor.

-Vendimi nr.61, datë 25.04.2019 (Caktim mase sigurimi)

Çështja është me objekt caktim mase sigurimi sipas nenit 244 të K.Pr.Penale. Kjo dispozitë nuk përcakton afat për shqyrtimin e kësaj lloji kërkesë. Është gjykuar për 9 ditë, pra brenda afatit standart dy muajor.

-Vendimi nr.68, datë 11.09.2019 (Pushim çështje penale)

Është përfunduar për 3 muaj e 27 ditë për arsyet objektive të mëposhtme:

Gjykata, me vendimin datë 28.05.2019, i ktheu aktet prokurorit për plotësimin e hetimeve, për të pyetur në cilësinë e dëshmitares shtetasen që kishte paraqitur kallëzimin për veprën penale/viktimën F.K.

Më datë 02.07.2019, prokurori riparaqiti në gjykatë kërkesën për pushimin e çështjes penale nr.278/2017 ndaj shtetasit Albert Maliqi.

Në lidhje me detyrat e caktuara nga gjykata, prokurori në kërkesë sqaroi se kishte qenë e pamundur pyetja e shtetasës F.K. për shkakun se ajo ishte larguar jashtë shtetit që prej datës 08.11.2018 dhe nuk ishte kthyer më, siç rezultonte nga procesverbali datë 01.07.2019 për këqyrjen e Sistemit TIMS.

Në seancë paraprake, gjykata ndërmori përpjekje për ta njoftuar personalisht kallëzuesen dhe arriti ta njoftonte për seancën e datës 11.09.2019 (për shkakun se ishte kthyer në Shqipëri), por ajo nuk u paraqit personalisht në seancë paraprake. Në këto kushte gjykata vijoi dhe përfundoi gjykimin e kërkesës në datë 11.09.2019.

Gjithashtu, në ecjen e afatit të gjykimit duhet pasur parasysh se në muajin Gusht kam qenë me leje vjetore sipas ligjit nr.96/2016.”

¹⁰ Në përlllogaritjen e numrit total të çështjeve për të cilat parashikohet afat ligjor gjykimi, si dhe të atyre të gjykuara jashtë këtij afati është mbajtur në konsideratë sa është sqaruar në referencën (9).

Kryetari e ka vlerësuar treguesin “*Plotësimi i standardeve minimale kohore*” në shkallë shumë të lartë.

Çështja penale, e evidentuar në raportin analitik si çështje, gjykimi i së cilës ka zgjat tej afatit standard të parashikuar nga ligji , nëse ne marrim parasysh lejen vjetore të muajit gusht, atëherë nga përlllogaritja duke zbritur këtë muaj rezulton se gjykimi i çështjes ka zgjatur 72 ditë. Pra çështja ka përfunduar jashtë afatit të parashikuar nga, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së afatin standard minimal 2 muaj dhe nëse zbresim lejen vjetoren te muajit gusht. Por duke marre parasysh sa është shpjeguar dhe nga gjyqtari në formularin e vetëvlerësimit pikërisht në lidhje me vendimi nr.68, datë 11.09.2019 (e evidentuar në raportin analitik si çështje gjykimi i së cilës ka zgjatur tej afatit standard te parashikuar), sa i përket ecures procedurale, konstatohet se ky afat ka zgjatur tej standardit te parashikuar për shkaqe të pavarura nga gjyqtari.

KONKLUZIONI

Referuar metodologjisë “ *Plotësimi i standardeve minimale kohore nënkupton respektimin nga ana e gjyqtarit të afateve orientuese të përcaktuara nga KLGJ, për çdo kategori çështjesh. Për të pikëzuar këtë tregues, vlerësimi bëhet referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor, me numrin total të çështjeve të gjykuara. Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi. Si burim vlerësimi shërbejnë të dhënat statistikore, vlerësimi i kryer nga gjyqtari dhe mendimi i kryetarit*”. Ky raport tregon se përqindja e çështjeve që rezultojnë të kenë përfunduar tej standardit minimal kohor të parashikuar, është 7% që sipas metodologjisë përkon me pikëzimin maksimal.

Sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, duhet pikëzuar me pikët maksimale.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “*respektimi i standardeve minimale kohore*” gjyqtari pikëzohet me 5 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara prej tij tej standardit minimal, është 0-10 %.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardet minimale kohore për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e shkurtër ose e barabartë me standardin, për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Gjyqtari subjekt vlerësimi ka gjykuar në total 10 çështje të kategorisë “*krime*”, 0 çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*”, 3 çështje të kategorisë “*seancë paraprake*”, si dhe 2 çështje të kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*”.

- Në lidhje me çështjet e kategorisë “*krime*”, koha mesatare rezulton të jetë 140

ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej nëntë dhe dymbëdhjetë muajsh.

- Në lidhje me çështjet e kategorisë “*seancë paraprake*”, koha mesatare rezulton të jetë 49 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh.
- Në lidhje me çështjet e kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*”, koha mesatare rezulton të jetë 33 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh.

Referuar vetëvlerësimit të gjyqtarit sipas formularit të integruar të vlerësimit, rezulton se: *Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” në shkallë shumë të lartë (nga pesë nivelet: e dobët; nën mesatare; mesatare; mbi mesataren; shumë e lartë), duke referuar të njëjtat shpjegime si në treguesin e afatit standard minimal kohor.*

Referuar mendimit të kryetarit sipas formularit të integruar të vlerësimit, rezulton se: *Kryetari e ka vlerësuar treguesin “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” në shkallë shumë të lartë*

KONKLuzioni

Duke i'u referuar vetëm analizës matematikore nga të dhënat statistikore, rezulton se për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet me 5 pikë, pasi koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është “*Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve*”, duke u pikëzuar me 5 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet si “Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve”, dhe pikëzohet me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Rezulton se për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, gjyqtari subjekt vlerësimi ka përfunduar 72 çështje gjyqësore, ndërkohë që i janë caktuar për gjykim 72 të tilla. Rrjedhimisht, rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore për subjektin e vlerësimit për periudhën 01.01.2019-31.12.2019 rezulton të jetë 100%.

Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “*Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore*” në shkallë shumë të lartë.

Kryetari e ka vlerësuar treguesin “*Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore*” në shkallë shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësuar në tërësinë e tyre, si dhe të dhënave statistikore, vlerësohet se rendimenti i përfundimit të çështjeve nga gjyqtari është në masën 100%.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, është “+99%”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh, krahasuar me afatin procedural të parashikuar në ligj, është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve. Konkretisht;

Për çështje të kategorisë “*krime*” koha mesatare e arsytimit është 10 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.

Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*” koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:

- Për kërkesa me objekt vleftësim arresti/ndalimi dhe caktim mase sigurimi, 2 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 të K. Pr. Penale.
- Për kërkesa me objekt verifikim i kushteve të zbatimit të masës së sigurimit, 2 ditë, pra sa afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 248 i K. Pr. Penale.
- Për kërkesa me objekt zëvendësim/revokim mase sigurimi, 4,6 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 i K. Pr. Penale.
- Për kërkesa me objekt shuarje mase sigurimi, 2 ditë, pra sa afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 261/3 dhe 248/2 i K. Penal.
- Për kërkesa me objekt lejim përgjimi/zgjatje afat përgjimi, 1 ditë, pra sa afati procedural 24 orë i parashikuar nga neni 222 i K. Pr. Penale.
- Për kërkesa me objekt caktim mase sigurimi, koha mesatare e arsytimit është 1 ditë, pra më e gjatë sa afati procedural i parashikuar nga neni 244/1 i K. Pr. Penale, i cili kërkon që vendimi të jepet i arsyetuar.
- Për kërkesa më objekt për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsytimin e vendimit, 3 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.

Për çështje të kategorisë “*seancë paraprake*” koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:

- Për çështje me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, 5 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 10 ditë i parashikuar nga neni 332/dh i K. Pr. Penale.

- Për çështje për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, 6 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.

Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:

- Për kërkesa me objekt shtyrje e ekzekutimit të vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 5 ditë, pra sa afati procedural 5 ditë i parashikuar nga neni 476 i K. Pr. Penale.
- Për kërkesa me objekt për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, 5 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.

Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor” në shkallë shumë të lartë (nga pesë nivelet: e dobët; nën mesatare; mesatare; mbi mesataren; shumë e lartë). Ky vetëvlerësim është argumentuar si vijon: “*Vendimet janë arsyetuar dhe dorëzuar në sekretari brenda afateve ligjore. Në ato raste kur ka pasur zgjatje të afateve, ato gjithmonë kanë qenë të shkurtra dhe tërësisht për shkaqe të objektive e të justifikuara, siç shpjegohet më poshtë:*

-Vendimi nr.60, datë 19.09.2019 (Vendim penal themeli)

Vendimi i arsyetuar është dorëzuar në sekretari për 40 ditë. Kjo është në përputhje me afatet e arsyetimit të vendimeve të parashikuara nga neni 382, pika 2, të K.Pr.Penale, përfshirë edhe zgjatjen e këtij afati në rastet e çështjeve që gjykohen nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Çështja konkrete kishte dy të pandehur, njëri ishte pa masë sigurimi, ndërsa i pandehuri tjetër ishte në mungesë të vullnetshme. Për zgjatjen e afatit të arsyetimit është njoftuar me shkresë kryetari i gjykatës, shkresë e cila është protokolluar. Zgjatja e afatit të arsyetimit ka ardhur për shkak të kompleksitetit të çështjes dhe volumit mjaft të madh të akteve të paraqitura nga Prokuroria (mbi 50 fashikuj).

-Vendimi nr.36, datë 22.01.2019 (Revokim mase sigurimi)

Dita e pestë pas shpalljes së vendimit i binte ditë e diel, prandaj vendimi është dorëzuar më datë 28.01.2019, që ka qenë ditë e hënë. Për këtë shkak është dorëzuar për 6 ditë.”.

Kryetari e ka vlerësuar treguesin “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor” në shkallë shumë të lartë (nga pesë nivelet: e dobët; nën mesatare; mesatare; mbi mesataren; shumë e lartë). Konkretisht, kryetari është shprehur si vijon: “*Të gjitha vendimet janë arsyetuar dhe dorëzuar nga gjyqtari Ardit Mustafaj brenda afateve ligjore. Koha e arsyetimit të vendimit përfundimtar ka qenë shpesh edhe më e shkurtër se afatet ligjore. Vetëm në një çështje gjyqtari ka kërkuar shtyrjen e afatit të dorëzimit të vendimit në sekretari (cituar nga gjyqtari në shpjegimet e tij) për arsye tërësisht objektive që lidheshin me kompleksitetin e çështjes dhe volumin e madh të akteve dhe provave të saj, por edhe në këtë rast shtyrja është bërë në përputhje me nenin 382, pika 2, të K.Pr.Penale, që parashikon zgjatjen e afatit të arsyetimit për çështjet që gjykohen nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Prandaj, aftësia e gjyqtarit Ardit Mustafaj për të arsyetuar në kohë sa më të shpejtë vendimet gjyqësore vlerësohet shumë e lartë.”.*

Nga të dhënat statistikore, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit është tejkaluar vetëm në një nënkategori:

- (i) Për kërkesa me objekt caktim mase sigurimi, koha mesatare e arsyetimit është 1 ditë, pra

më e gjatë sa afati procedural i parashikuar nga neni 244/1 i K. Pr. Penale, i cili kërkon që vendimi të jepet i arsyetuar, rezulton se afati procedural të jetë tejkaluar me orë, çka e bën të papërfillshëm për tu marrë në konsideratë.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar duhet të klasifikohet si “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, prandaj gjyqtari pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, është “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, dhe pikëzohet me 15 pikë.*

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh, sipas të dhënave nga statistikat duke përjashtuar ato pa palë kundërshtare, për kategorinë “Krime” është 13 seanca dhe për kategorinë “Sanca paraprake” është 3 seanca, pra në total, numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh është 8 seanca.

Në tërësi, për të dyja kategoritë e çështjeve “krime” dhe “seancë paraprake” rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 8

Referuar vetëvlerësimit të gjyqtarit sipas formularit të integruar të vlerësimit, rezulton se:

Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive” në shkallë të lartë (nga tre nivelet: e dobët; mesatare; e lartë). Ky vetëvlerësim është argumentuar si vijon: “Fillimisht, sqaroj se në dy prej çështjeve numri i seancave është shënuar gabim në të dhënat statistikore vënë në dispozicion KLGJ-së nga Gjykata (janë gabime materiale në të shkruar), konkretisht:

-te çështja penale e themelit që i përket vendimit nr.27, datë 24.12.2019, janë zhvilluar gjithsej 2 seanca, jo 22 (përveçse është e verifikueshme nga procesverbali gjyqësor, kjo duket që në pamje të parë edhe nga fakti se për 2 muaj që ka zgjatur gjykimi, 22 seanca gjyqësore është një numër tepër i lartë);

-te çështja penale e themelit që i përket vendimit nr.28, datë 26.12.2019, janë zhvilluar gjithsej 3 seanca, jo 23 (përveçse është e verifikueshme nga procesverbali gjyqësor, kjo duket që në pamje të parë edhe nga fakti se për 3 muaj e 20 ditë që ka zgjatur gjykimi, 23 seanca gjyqësore është një numër tepër i lartë).

Në çështjet penale të themelit, numri i seancave ka qenë më i lartë për shkak të kompleksitetit të këtyre çështjeve, të cilat janë të sferës së krimit të organizuar dhe trafikimit të narkotikëve,

që i përkisnin/përkasin kompetencës lëndore të Gjykatës për Krime të Rënda/Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Gjithashtu, në disa prej çështjeve ka qenë e nevojshme që të kryheshin procedurat e njoftimit dhe kërkimit të të pandehurve sipas neneve 140-141 të K.Pr.Penale apo njoftimi i tyre jashtë shtetit, për të cilat janë nevojitur disa seanca, konkretisht:

-te vendimi nr.7, datë 24.01.2019, e pandehura Ljubica Zucovikj u njoftua jashtë shtetit dhe janë nevojitur disa seanca pasi nuk kthehej përgjigja e njoftimit, ndërsa 2 seanca janë shtyrë për mungesë për shkaqe objektive të anëtarëve të trupit gjykues;

-te vendimi nr.40, datë 24.05.2023, për të pandehurin Armand Qotaj u kryen procedurat e njoftimit dhe kërkimit dhe më pas çështja ndaj tij u pezullua dhe u nda;

-te vendimi nr.60, datë 19.09.2019, për të pandehurit Sokol Bode dhe Gjergji Kohila u kryen procedurat e njoftimit dhe kërkimit dhe më pas çështja ndaj tyre u pezullua dhe u nda;

-te vendimi nr.72, datë 06.11.2019, për të pandehurin Ardit Xheleshi, i cili nuk u gjet megjithë kërkimet e kryera, gjykimi u pezullua dhe rifilloi pasi ai u arrestua në Gjermani dhe u ekstradua në Shqipëri;

-te vendimi nr.77, datë 22.11.2019, gjykimi u zhvillua sipas rregullave të gjykimit të zakonshëm dhe çështja ishte e sferës së krimit të organizuar.

Ndërsa në çështjet ku janë gjykuar kërkesat për dërgim çështje në gjyq, kërkesat për pushim çështje, si dhe kërkesat e tjera penale, numri i seancave gjyqësore mesatarisht ka qenë i vogël.”.

Kryetari e ka vlerësuar treguesin “Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive” në shkallë të lartë (nga tre nivelet: e dobët; mesatare; e lartë).

Duke patur parasysh sa më lart nga shpjegimet e gjyqtarit në formularin e vetëvlerësimit, rezulton se për kategorinë “Krime” , numri mesatar i seancave nga përllogaritja e bërë është 8 seanca dhe për kategorinë “Seanca paraprake” është 3 seanca, pra në total, numri mesatar i seancave gjyqësore për të dy kategoritë e çështjes është 6 seanca.

Pavarësisht numrit të lartë të seancave në çështjet e kategorisë “Krime”, duke marrë parasysh dhe vlerësuar te gjitha të dhënat që na rezultojnë nga burimet e vlerësimit, konstatohet se nga ana e gjyqtarit janë marrë të gjitha masat e nevojshme, për të zhvilluar dhe përfunduar procesin në kohë, si dhe janë kryer të gjitha veprimet procedurale të nevojshme për zhvillimin e seancave efektive. Shtyrjet e seancave kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjykatës, por në funksion të shqyrtimit të çështjeve, konform një procesi të rregullt ligjor, në mënyrë që afati i arsyeshëm për shqyrtimin e çështjeve të mos bëhej shkak për cenimin e të drejtave procedurale të palëve në proces, një nga shkaqe e shumta ka qenë e njoftimi të pandehurve.

KONKLUZIONI

Referuar sa më sipër, për treguesin “Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi çështjeve me palë kundërshtarë të përzgjedhura me short, te dhënave statistikore, shpjegimeve te gjyqtarit dhe kryetarit në formularin e vetëvlerësimit, rezulton se gjyqtari duhet të vlerësohet maksimalisht për këtë tregues pasi ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive, planifikimin në një kohë shumë të shkurtër dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, pikëzohet me 15 pikë, pasi gjyqtari ka kryer veprimet e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjyqtari në të gjitha çështjet e përzgjedhura me short e ka venë në lëvizje dosjen po atë ditë që caktohej me cilësinë e relatorit së çështjes. Gjithashtu, rezulton se ka kryer të gjitha veprimet procedurale, gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara në dosje si: vendimi për caktimin e seancës gjyqësore, vendimi për pezullimin dhe ndarjen e çështjes, etj.

Gjyqtari ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës së parë gjyqësore në çdo rast 0 deri 3 ditë pas caktimit të çështjes me short dhe në të njëjtën ditë me nxjerrjen e urdhrin të Kryetarit për formimin e trupit gjykues, duke respektuar afatin procedural 10 ditor të parashikuar nga neni 333/1 i Kodit të Procedurës Penale.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur me regjistrim audio si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Seancat gjyqësore janë zhvilluar në mënyrë korrekte duke ndjekur ecurinë procedurale të gjyqimit penal sipas parashikimeve të nenit 335 e vijues të K.Pr.P dhe 405 e vijues në rastet e procedimit me gjykim të shkurtuar. Gjatë zhvillimit të gjyqimit gjyqtari tregon kujdes të posaçëm për të relatuar regjistrimin e seancës në sistemin audio, relatimin e verifikimit të paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjyqimit, marrjen e vendimeve për zhvillimin e gjyqimit në mungesë sipas parashikimeve të nenit 351 dhe 352 të K.Pr.P, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar (gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar), administrimin e provave, dhënien e fjalës palëve për diskutimin përfundimtar, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (njoftimin e palëve, shoqërimin e të pandehurve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.)

Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes. Në dosje të vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur përgjithësisht në orarin e caktuar, gjithmonë është shoqëruar me relatimin e shkakut në rastet e çeljes me vonesë, por nuk rezulton që seancat të mos jenë zhvilluar për shkak të kësaj vonese.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt

ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes, evidentohet se aktet në dosje janë renditur në mënyrë të rregullt, duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit), brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjeve gjyqësore është e rregullt dhe dokumentacioni është lehtësisht i aksesueshëm, duke përmbajtur aktin e shortit, urdhrin e formimit të trupit gjykues, urdhër për caktimin e seancës gjyqësore, njoftimet në rend kronologjik, provat e administruara gjatë gjykimit, vendimi për pezullimin dhe ndarjen e çështjes, diskutimet me shkrim të palëve, procesverbalet e seancave sipas datave dhe vendimin përfundimtar të gjykatës, CD-ja e regjistrimit audio të seancave gjyqësore.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (njoftimet, procesverbalet e seancave). Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe nga gjykatat më të larta. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari Ardit Mustafaj ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” është “shumë e lartë” pikëzohet me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se në dosjet e përzgjedhura me short ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata, në përputhje me veprimet procedurale të kryera (njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance, vendimet gjyqësore), si dhe aktet e paraqitura nga palët (provat e administruara gjatë gjykimit, diskutimet përfundimtare të palëve).

Në përgjithësi nuk rezultojnë prani të dokumentacionit apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete në dosjet e vëzhguara, por rezulton se në dosjet burim vlerësimi nuk është e administruar “Letra e të drejtave”, e cila i bashkëlidhet njoftimit për të pandehurin, personit nën hetim apo të dëmtuarit nga vepra penale. Ndërkohë që komunikimi me shkrim i saj, bashkëlidhur njoftimit për seancën gjyqësore, parashikohet në mënyrë të shprehur në nenet 34/a,¹¹ 58,¹² 140 paragrafi 1¹³ dhe 137¹⁴ i K.Pr.Penale. Vetëm në njërin nga dosjet burim vlerësimi konkretisht në çështjen nr. 40 vendimi, datë vendimi 24.05.2019, me objekt “Gjykimin për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a2-22 i K.Penal”, konstatohet se pas vendim “Për caktimin e seancës gjyqësore” dhe njoftimeve ndodhet e administruar letra e të drejtave.

Pavarësisht se të drejtat e parashikuara nga nenet 34/a dhe 58 të K.Pr.Penale subjekteve i janë garantuar duke ju bërë me dije edhe gjatë zhvillimit të gjyimit, mos administrimi i kopjes me shkrim të këtij akti, bashkëlidhur kopjes së njoftimit që administrohet në dosjen gjyqësore, përbën një të dhënë që duhet vlerësuar në drejtim të plotësisë së dokumentacionit të dosjes.

Gjyqtari Ardit Mustafaj paraqiti kundërshtimet duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si me poshtë:

“Krahas faktit se të drejtat e parashikuara nga nenet 34/a dhe 58 të K.Pr.Penale subjekteve u janë garantuar nga ana ime si gjyqtar duke ju bërë me dije edhe gjatë zhvillimit të gjyimit (sikurse ka evidentuar edhe Projektraporti), sqaroj se: “Letra e të drejtave” u është dorëzuar të pandehurve dhe personave nën hetim që në fazën e hetimit paraprak, fakt që e kam verifikuar në momentin që jam njohur me dosjen, dhe për këtë arsye kam vlerësuar se ky veprim procedural tashmë ishte kryer. Këtu kam mbajtur parasysh edhe faktin e rëndësishëm se këto të drejta nuk kishin pësuar ndonjë ndryshim që nga faza e hetimit paraprak, pasi dispozitat e K.Pr.Penale, që parashikojnë të drejtat e të pandehurit, nuk kanë ndryshuar që nga koha e miratimit të tyre në vitin 2017 e deri në momentin që unë po gjykoja këto çështje. Duke qenë se “letra e të drejtave” praktikisht u është dorëzuar të pandehurve/personave nën hetim gjatë procedimit penal, duke qenë në kushtet e mungesës së rregullimeve specifike ligjore për numrin e herëve që u duhet dorëzuar letra e të drejtave këtyre subjekteve, si dhe duke qenë në kushtet që në asnjë nga çështjet e mësipërme nuk janë kryer akte që kërkonin prani të detyrueshme të të pandehurit, ju parashtroj këtë kërkesë që vlerësimi lidhur me treguesin 2.C.b “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes”, të jetë “shumë e lartë - 10 pikë”, sikurse parashikohet në Metodologjinë e Pikëzimit. Krahas argumenteve të mësipërme, shtoj se, edhe duke pranuar standartin e ndjekur nga KLGJ, duhet të konsiderohet se nuk kanë “letrën e drejtave” vetëm 3 dosje, nga 6 dosje të përzgjedhura me

¹¹ Në nenin 34/a, pika 2 dhe 3 të K.Pr.Penale parashikohet se: “2. Përpara marrjes në pyetje për herë të parë ose përpara kryerjes së akteve ku prania e tij është e detyrueshme, sipas ligjit, organi procedues e njofton të pandehurin për të drejtat e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, duke i dhënë, kundrejt nënshkrimit, letrën e të drejtave në formë të shkruar. 3. Të drejtat dhe garancitë e parashikuara për të pandehurin zbatohen edhe për personin nën hetim dhe personin, të cilit i atribuohet vepra penale, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon ndryshe”.

¹²Neni 58 pika 2 i K.Pr.Penale parashikon se: “2. Organi procedues njofton menjëherë viktimën për të drejtat e përmendura në paragrafin 1, të këtij neni, dhe mban procesverbal për njoftimin e tyre”.

¹³Neni 140, paragrafi 1 i K.Pr.Penale parashikon se: “1. Njoftimi për herë të parë i të pandehurit në gjendje të lirë bëhet duke i dorëzuar atij personalisht kopjen e aktit së bashku me letrën e të drejtave, sipas nenit 34/a, të këtij Kodi....”.

¹⁴Neni 137, paragrafi 1 i K.Pr.Penale parashikon se: “1. Njoftimet për personin e dëmtuar nga vepra penale bëhen njëjloj si për rastet kur njoftohet për herë të parë i pandehuri i lirë....”.

short. Lidhur me 3 të tjerat, 1 dosje e ka letrën e të drejtave, ndërsa 2 dosje për nga natyra e gjykimit nuk kërkojnë dorëzimin e “letrës së të drejtave”. Në këto kushte, gjykoj se vlerësimi “mbi mesataren - 8 pikë” nuk është proporcional. Prandaj, duke marrë parasysh në tërësi edhe faktorët e tjerë të përmendur më lart, gjykoj se vlerësimi më i drejtë dhe proporcional i këtij treguesi do të ishte “shumë e lartë - 10 pikë”, ose minimalisht 9 pikë”.

Për të vërtetuar sa më sipër, gjyqtari Ardit Mustafaj ka bashkëngjitur dhe prova lidhje me sa ka parashtruar në kundërshtime.

KONKLUZIONI

Bazuar në sa më sipër, Këshilli duke marrë parasysh dhe kundërshtimet e paraqitura nga ana e gjyqtarit, të diskutuara në mbledhjen plenare, arriti në përfundimin që gjyqtari të vlerësohet me pikëzim maksimal.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është “lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Nivelin i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se për gjyqtarin Ardit Mustafaj, gjatë periudhës së vlerësimit nuk janë dhënë ose zbatuar masa disiplinore.

Sa i përket ankesave, për periudhën e vlerësimit viti 2019, ndaj gjyqtarit, sipas informacionit të përcjellë nga ILD me shkresën nr. 2106/1 prot, datë 04.07.2023, nuk rezulton të jenë paraqitur ankesa.

Në formularin e integruar të vlerësimit gjyqtari e ka vlerësuar veten në nivelin maksimal për këtë tregues ndërkohë që nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me të.

Kryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues e ka vlerësuar gjyqtaren me nivel shumë të lartë etik duke parashtruar *se gjyqtari Ardit Mustafaj ka treguar sjellje etike, ka qenë korrekt, serioz, i përkushtuar në punë, si dhe në marrëdhëniet dhe komunikimin e përditshëm gjatë ushtrimit të detyrës. Gjithashtu ai ka treguar vetëpërmbytje, korrektësi, maturi dhe qartësi në marrëdhëniet me kolegët, me stafin administrativ të gjykatës, si dhe palët në proces. Ka shmangur çdo sjellje që tregon mungesë respekti, vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendjeje apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive. Për treguesin e angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion vlerësimi duhet të jetë shumë i lartë.”*

KONKLUZIONI

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna që mund të tregojnë cenimin e etikës, angazhimit apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarit, gjatë ushtrimit të detyrës. Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri të lartë në funksion dhe nuk ka shfaqur sjellje që mund të cenojë etikën në punën e tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë dhe duhet të pikëzohet më pikët maksimale.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, etika e gjyqtarit në lidhje me treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “shumë e lartë” duhet pikëzuar me 35 pikë.

3.B Integriteti i gjyqtarit

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, rezulton se për gjyqtarin Ardit Mustafaj nuk është regjistruar asnjë ankesë në ILD dhe ndaj tij nuk janë marrë apo zbatuar masa disiplinore.

Në raportin e ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr. 83/23 prot., datë 05.05.2023, konkludohet se *deklarimi i pasurisë është i saktë dhe në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Gjyqtari dhe kryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar integritetin e gjyqtarit në nivel shumë të lartë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjtetit të gjyqtarit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim apo çdo sjelle tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarit.

KONKLUSIONE:

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtarit, vlerësohet se gjyqtari duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjellëve të pahijshme apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e integritetit të gjyqtarit në treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtarit

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në raportin analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari Ardit Mustafaj në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të tij. Gjithashtu nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjet e gjykimit si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe vlerësimi i kryetarit të gjykatës.

KONKLUSIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në treguesin “shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se për periudhën 01 janar 2019–31 Dhjetor 2019, është paraqitur vetëm 1 (një) kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit dhe rezulton të jetë rrezuar. Po kështu, rezulton se vetë gjyqtarja ka paraqitur 2 (dy) kërkesa për heqje dorë, të cilat rezultojnë të jenë pranuar.

Për këto arsye, për këtë tregues vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, duhet të vlerësohet si “I pakonsiderueshëm”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, duhet të vlerësohet si “I pakonsiderueshëm”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjyqtari gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë, transparente, i kuptueshëm. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe e drejtpërdrejtë. Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes për të qenë i qartë, i drejtpërdrejtë dhe i kuptueshëm dhe duhet të vlerësohet maksimalisht për këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk evidentohet asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për rrjedhje, prezumohet se gjyqtari Ardit Mustafaj ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

KONKLUSIONE:

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhje, në mungesë të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit të gjyqtarit me koleget, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivelin “Shumë e lartë”.

Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “*Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta*” në shkallë shumë të lartë ndërkohë nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me të.

Kryetari e ka vlerësuar treguesin “*Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta*” në shkallë shumë të lartë duke theksuar se Gjyqtari Ardit Mustafaj është treguar shumë i angazhuar për ngritjen e problemeve për çështje të caktuara juridike, merr pjesë në mënyrë aktive në diskutimet që zhvillohen me kolegët lidhur me zbatimin e vendimeve njehsuese dhe për unifikimin e praktikave dhe akteve procedurale brenda gjykatës, si dhe gjithmonë ndan me kolegët dijet dhe përvojën e fituar në aktivitete të ndryshe trajnuese.

KONKLUSIONE:

Nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “shumë e lartë” duhet pikëzuar me 15 pikë.*

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore ndërkohë që gjyqtari dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë duke parashtruar se gjyqtari “Gjyqtari Ardit Mustafaj është treguar komunikues dhe bashkëpunues me administratën gjyqësore. Aftësia e tij lidhur me këtë tregues është shumë e lartë.”

KONKLUZIONE:

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, është shumë e lartë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “shumë e lartë” dhe duhet pikëzuar me 10 pikë.*

4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjyqtar Ardit Mustafaj, përgjatë vitit kalendarik 2019 ka marrë pjesë në 8 aktivitete trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës, në rolin e pjesëmarrësit dhe ekspertit, konvertuar në numër ditësh 30.5 ditë. Kohëzgjatje kjo që është brenda kufijve të parashikuar deri në 40 ditë në vit, në periudhën një vjeçare të vlerësimit.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues të pikëzohet me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjyqtari Ardit Mustafaj ka marrë pjesë në cilësinë e lehtësuesit/ekspertit në aktivitetet trajnuese në bazë të informacionit të përcjellë prej Shkollës së Magjistraturës me shkresën nr. 720 prot., datë 13.10.2023.

Për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, Gjyqtari Ardit Mustafaj rezulton se ka marrë pjesë si ekspert në programe të trajnimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, si më poshtë:

- Në aktivitetin e datës 23-24 janar 2019 dhe 25-26 shkurt 2019, me temë: “*Drejtësia penale për të mitur. Standardet ndërkombëtare lidhur me parimet e drejtësisë miqësore për të miturit dhe risitë e legjislacionit shqiptar (Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur). Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës. Pozita procedurale e të miturit në dhe gjatë procesit penal sipas Kodit të drejtësisë Penale për të Mitur. Shmangia nga ndjekja penale e të miturit në konflikt me ligjin. Të drejtat procedurale të të miturit në konflikt me ligjin.*”.
- Në aktivitetin e datës 15 mars 2019, me temë “*Njohja e vendimeve penale të huaja. Transferimi i procedimeve të të dënuarve*”.
- Në aktivitetin e datës 3-4 prill 2019, me temë: “*Trafikimi i narkotikëve. Kuptimi dhe elementët e veprës penale të trafikimit të narkotikëve dhe problemet e formulimit normativ të saj. Qëndrimi i mbajtur nga praktika gjyqësore për rastet kur kjo veprë mbetet në tentativë. Vështirësitë në hetimin dhe gjykimin e kësaj veprë penale kur ajo kryhet nga krimi i organizuar.*”.
- Në aktivitetin e datës 23-24 prill 2019, me temë: “*Parandalimi dhe lufta kundër trafikimit me fokus: Trafikimin e armëve dhe municioneve luftarake; Trafikimin e mjeteve motorike dhe veprave të artit dhe kulturës; Rëndësia e bashkëpunimit ndërinstytucional mes institucioneve ligjzbatuese.*”.
- Në aktivitetin e datës 2-3 dhjetor 2019, me temë: “*Shmangia nga ndjekja penale e të miturit në konflikt me ligjin: Drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi; Praktika e prokurorisë dhe gjykatës.*”.

Referuar metodologjisë “..... Këshilli konsideron vlerë të shtuar për gjyqtarin gatishmërinë e tij për të kontribuar si gjyqtar udhëheqës në praktikën profesionale të kandidatëve për gjyqtarë, dhe/ose si ekspert/lehtësues në trajnimin fillestar apo vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, apo në trajnime të organizuara nga institucione të tjera. Duke marrë parasysh se pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët e fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë. Dy pikë të tjera iu shtohen në vlerësim gjyqtarëve që e kryejnë këtë veprimtari njëkohësisht me veprimtarinë gjyqësore, pavarësisht nga frekuenca e angazhimit. Burim vlerësimi për këtë kriter është dosja personale e gjyqtarit dhe informacioni me shkrim që përcillet nga Shkolla e

Magjistraturës ose institucione të tjera, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e gjyqtarit në veprimtaritë trajnuese

KONKLUZIONI

Sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, duhet të pikëzohet me piket maksimale.

***Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, pikëzohet me 5 pikë.*

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton që gjyqtari gjatë vitit 2019 të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, apo aktivitete të tjera.

Në këtë kuadër, gjyqtari subjekt vlerësimi rezulton të ketë paraqitur vërtetimin me nr. 674/1 datë 25.07.2023 të lëshuar nga Burimet Njerëzore të Fakultetit të Drejtësisë Universiteti i Tiranës, nga përmbajtja e të cilit rezulton se gjyqtari Ardit Mustafaj për periudhën e vlerësimit 2019-2020 në semestrin e parë ka dhënë lëndën “Ekonomia dhe Kriminaliteti” Master profesional.

KONKLUZIONI

Sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, duhet të pikëzohet me piket maksimale.

***Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues pikëzohet me 5 pikë.*

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton që gjyqtarja të ketë realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, nuk mund të vlerësohet me pikë për këtë tregues.

Gjyqtari Ardit Mustafaj paraqiti kundërshtime sa i përket këtij treguesi duke parashtruar se: *Nga Raporti rezulton se treguesi 4.C.ç. “Publikimet ligjore akademike” është vlerësuar me 0 pikë, nga 5 të mundshme. Kjo ka ardhur si pasojë se KLGJ nuk ka pasur të dhëna në këtë drejtim. Lidhur me këtë tregues sqarohet se në vitin 2019, pranë Shkollës së Magjistraturës*

kam paraqitur punimin me titull “Mbrojtja e të drejtave të të miturit dëshmitar (Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur)”, i cili është publikuar nga ana e Shkollës së Magjistraturës në faqen zyrtare të saj, sikurse konfirmohet nga shkresa e saj kthim përgjigje nr.781/1 prot., datë 06.11.2023. Sa më sipër, bashkëngjitur ju paraqes si provë: shkresë nr.781/1 prot., datë 06.11.2023, e Shkollës së Magjistraturës Tiranë, bashkëngjitur së cilës ndodhet edhe punimi (15 fletë gjithsej). Për këto arsye, duke qenë se gjatë vitit 2019 janë realizuar nga ana ime publikime ligjore akademike, ju parashtroj këtë kërkesë që vlerësimi lidhur me treguesin 4.C.ç. “Publikimet ligjore akademike”, të jetë maksimal, 5 pikë”.

Bazuar në sa më sipër Këshilli, në mbledhjen plenare pasi mori në diskutim kundërshtimet e gjyqtarit Ardit Mustafaj ne lidhje me treguesin 4.C.ç. “Publikimet ligjore akademike”, vlerësoi se për këtë tregues gjyqtari nuk mund te vlerësohet me 5 pikë, pasi publikimi i sipërpërmendur është një botim i bërë faqen zyrtare të Shkollës së Magjistraturës. Referuar Metodologjise në lidhje me këtë tregues përcaktohet qartë si më poshtë:

“Me anë të këtij kriteri, Këshilli konsideron vlerë të shtuar për gjyqtarin **publikime ligjore akademike** me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës. I deri 5 pikë caktohen për publikimet ligjore akademike, ku përfshihen artikuj, kapituj, monografi, ose publikime shkencore të tjera, të botuara brenda dhe jashtë vendit, të shoqëruara me numër identifikimi (ISBN, ISSN)”.

Referuar në sa më sipër, në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një publikim ligjor apo akademik. Punimi me titull “Mbrojtja e të drejtave të të miturit dëshmitar (Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur)”, është në kuadër të kontributit të tij si gjyqtar në rolin e ekspert/lehtësues në trajnimin fillestar apo vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, kontribut për të cilin është vlerësuar në treguesin: 4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve. Në këto kushte gjyqtari Ardit Mustafaj nuk mund të pikëzohet maksimalisht për këtë tregues.

Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Publikimet ligjore akademike” gjyqtarja duhet të pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
95	Shkëlqyeshëm

NDARJA F- NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	95	Shkëlqyeshëm
Propozim për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	395	Shkëlqyeshëm

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR